



ALEANCA PËR FËMIJËT SHQIPËRI



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

## KARTA RAJONALE RAPORTUESE – QARKU SHKODËR

“Gjendja e fëmijëve Romë dhe Egjiptian” për vitin 2011



### QARKU SHKODËR

Eksperte Rajonale  
Anilda Shestani (Gurakuqi)

## LISTA E SHKURTIMEVE

ASHMDF	- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
VKM	- Vendime të Këshillit të Ministrave
Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
ACA	- Aleanca Për Fëmijët në Shqipëri
DAR	- Drejtoria Arsimore Rajonale
DSHP	- Drejtoria e Shëndetit Publik
DRSHSSH	- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
NE	- Ndihmë Ekonomike
SC	- Save the Children
NJDF	- Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
DRP	- Drejtoria Rajonale e Punësimit
QSH	- Qendër Shëndetësore
KQ	- Këshilli i Qarkut
MASH	- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
KDF	- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

## I - Parathënie dhe falënderime

Projekti "Observatorët për të drejtat e Fëmijëve" i Aleancës Kombëtare për Fëmijë financiar përmes Zyrës së UNICEF Shqipëri shtriu aktivitetin e saj në Qarkun Shkodër që në Maj të vitit 2009.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve si një strukturë e shoqërisë civile ka forcuar tashmë aleancat në harmonizimin e bashkëpunimit duke rritur përpjekjet efektive për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Observatorët për të Drejtat e Fëmijëve realizojnë grumbullimin periodik të treguesve statistikor nga institucionet shtetërore rajonale; njësitë e qeverisjes vendore gjer në nivelin e komunave; organizatat e shoqërisë civile; komunitetet dhe vetë fëmijët në nivel rajonal dhe lokal. Mbi këta tregues realizohet analiza periodike dhe e vazhdueshme e informacionit dhe hartohen raporte vjetore lidhur me situatën e gjendjes së të drejtave të fëmijëve në fushën e së drejtës për Kujdes Shëndetësor; Mbrojtje Sociale; Edukim dhe Pjesëmarrje.

Përmes mbledhjes së informacionit mbi të drejtat e fëmijëve dhe me mbështetjen e vazhdueshme institucionale dhe bashkëpunimin e ndërsjellët të Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit, Observatori Shkodër ka arritur të krijojë dhe të konsolidojë tashmë mekanizmin e mbledhjes së të dhënave që lidhen me mirëqenien e fëmijëve.

Informacioni i shkëmbyer reciprokisht me institucionet rajonale apo ato të qeverisjes vendore qoftë të njërive vendore si Bashki apo Komuna; gjithashtu me organizatat e qeverisjes vendore por edhe shpërndarja e raporteve përkatëse e bën Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve "Zyrë Burimore për të Drejtat e Fëmijëve" në Qarkun Shkodër.

Një fokus të veçantë Observatori ka pasur edhe raportimin mbi të drejtat e Fëmijëve me qëllim jo vetëm paraqitjen e situatës së të drejtave të fëmijëve në Qarkun Shkodër por edhe orientimin e pushtetit vendor në promovimin e politikave favorizuese në mbrojtje të drejtave të Fëmijëve. Observatori ishte iniciator por edhe pjesë e grupit teknik për hartimin e një dokumenti shumë të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve siç është dhe Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijët 2011-2013 të Këshillit të Qarkut Shkodër, dokument publikuar me mbështetjen financiare të Zyrës së UNICEF Shqipëri.

Gjithashtu përmes raporteve të Observatorit është bërë e mundur jo vetëm paraqitja e situatës së realizimit të drejtave të fëmijëve në Qarkun Shkodër por edhe lobimi dhe advokimi në rrjetin e Aleancës për Fëmijë, organizatave të shoqërisë civile, NJDF-së në nivel Qarku si dhe NJMF-së në nivel Bashkie. I gjithë ky proces ka konsistuar në sensibilizimin e gjithë aktorëve përgjegjës për më shumë vëmendje ndaj të drejtave të Fëmijëve e krijimin e mekanizmave mbrojtës për fëmijët edhe në nivel të Komunave të Qarkut Shkodër.

Raporti Studimor "Gjendja e Fëmijëve Romë e Egjiptianë" në Qarkun Shkodër është përgatitur nga Zyra e Observatorit Shkodër dhe është i bazuar në të dhënat e grumbulluara kryesisht nga fokus grupet në tre njësi administrative dhe gjithashtu nga të dhëna, statistika, informacione sasiore dhe cilësore të ardhura nga institucionet rajonale të qeverisjes vendore dhe nga organizatat e shoqërisë civile.

Observatori Shkodër fillimisht dëshiron të falënderojë dhe është mirënjohës një numri të gjerë anëtarësh të minoritetit romë e komunitetit egjiptianë; nëna; baballarë; të rinj të këtyre

komuniteteve për gatishmërinë e tyre dhe që gjatë zhvillimeve të fokus grupeve ofruan informacion të vlefshëm mbi gjendjen e realizimit së të drejtave të fëmijëve të këtyre komuniteteve.

Një falënderim të veçantë për znj. Mimoza Ceni, përfaqësuese e DRSSHS Shkodër dhe administratoret sociale të Bashkisë Vau i Dejës dhe Komunës Bërdicë jo vetëm për lehtësimin në zhvillimin e fokus grupeve por edhe për informacionin e ofruar për gjendjen e reale të minoritetit romë në këto njësi të qeverisjes vendore.

Falënderojmë Z. Alfred Koçobashi, përfaqësues i Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Shkodër për ndërmjetësimin dhe mbështetjen në procesin e marrjes së të dhënave statistikore lidhur me studimin.

Gjithashtu Observatori Shkodër dëshiron të falënderojë një numër të gjerë profesionistësh të cilët më ofrimin e të dhënave sasiore dhe cilësore ndihmuan jo vetëm në realizimin e këtij raporti por edhe në pasqyrimin e politikave ndërinstitucionale të organeve të qeverisjes vendore dhe të shoqërisë civile që po ndërmerren me qëllim realizimin e të drejtave të fëmijëve romë dhe egjiptianë në Qarkun Shkodër. Falënderojmë znj. Gjulita Serreqi (DAR Shkodër), Znj. Julia Cepi (Bashkia Shkodër); Znj. Vilma Shiroka (Këshilli i Qarkut Shkodër); Znj. Rita Tokrri (Drejtoria Rajonale e Punësimit) Znj. Helga Smakaj (SOS Fshatrat e Fëmijëve Shkodër); znj. Arlinda Bilali (World Vision), Znj. Orjeta Cungu (Malteser); stafin mësimor të kopshtit publik “Guerrile”; të shkollave “Salo Halili” dhe “Liria” ku ka përfshirje të fëmijëve romë e egjiptianë në arsim si dhe personelin mjekësor të Qendrave Shëndetësore Nr.1 Ambulanca “28 Nëntori” e “Ahmet Haxhia” në Shkodër. Në përfundim të realizimit të këtij studimi, me shumë kënaqësi do dëshiroja të falënderoja në mënyrë të veçantë stafin e Aleancës për Fëmijët Shqipëri (ACA), Znj. Suzana Sakiqi, drejtuese e ACA si dhe znj. Elma Tërshana, koordinatore kombëtare e Observatorit për ofrimin e gjithë mbështetjes së tyre profesionale dhe të përkushtuar, dhënë gjatë gjithë periudhës së shkrimit të këtij raport studimi.

## II - Hyrja

Qarku Shkodër është një nga më të rëndësishmit dhe më i madhi në Veriun e Shqipërisë. Në vitin 2011 numëron një popullsi prej 328,607 banoresh nga të cilët 82,886 janë fëmijë<sup>1</sup> të grupmoshës 0-18 vjeç. Nën ndikimin e dukurive sociale<sup>2</sup>, të tilla si emigracioni, urbanizimi i pakontrolluar, varfëria e papunësia, des-integrimi i familjes e divorcet, vërehet rritje e numrit dhe e shkallës së prekmërisë sociale për kategoritë e ndryshme të fëmijëve. Konkretisht, Qarku Shkodër është me një *nivel të lartë varfërie*, krahasuar me pjesën tjetër të vendit (indeksi i varfërisë 36,7 % krahasuar me 25,4%, që është mesatarja e vendit)<sup>3</sup>.

Varfëria jo vetëm përfaqëson mungesën e të ardhurave apo të papunësisë, por edhe mungesën e plotësimit të nevojave sociale bazë (arsim; shëndetësi; mbrojtje sociale; kushte banimi; higjienë; diskriminim; mospjesëmarrje etj) të grupeve më të përjashtuara të shoqërisë. Vërehet se shkalla e përjashtimit apo rrezikut social në përgjithësi lidhet ngushtë me treguesit e varfërisë ekonomike.

Observatori Shkodër, përmes analizimit të dhënave ka pasur si qëllim të paraqesë përmes raporteve të tij të mëparshme situatën e realizimit së të drejtave të fëmijëve në Qarkun Shkodër.

<sup>1</sup> Zyra e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, 2012

<sup>2</sup> Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijë Qarku Shkodër, fq 5

<sup>3</sup> Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijë Qarku Shkodër, fq 20

Në këtë kontekst kategoria e fëmijëve të komunitetit romë, egjiptianë është shënuar si kategoria e fëmijëve më të përjashtuar në Qarkun Shkodër në mënyrë krahasore me të tjerët<sup>4</sup>.

Në Qarkun Shkodër nuk ka statistika të sakta mbi numrin e popullsisë romë/ egjiptianë dhe në të njëjtën kohë nuk ka raporte që ofrojnë tablo të detajuar në lidhje me gjendjen e realizimit së drejtave të fëmijëve të këtij komuniteti. Gjithashtu Strategjia Rajonale për Fëmijët e Këshillit të Qarkut dhe Plani Social i Bashkisë Shkodër prekin në mënyrë të tërthortë problematikat e fëmijëve romë dhe egjiptianë apo ofrojnë të dhëna jo të plota lidhur me numrin e popullsisë të këtyre komuniteteve, vendbanimet e tyre në Qarkun Shkodër apo mbi shkallën e përfshirjes në shërbimet shoqërore.

*Mungesa e të dhënave rreth realizimit të drejtave të fëmijëve romë/egjiptianë mund të sjellë pengesa në planifikimin, financimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve për përmirësimin e situatës së drejtave të këtij komuniteti qoftë nga ana e shtetit ashtu edhe nga ana e shoqërisë civile.*

### **Qëllimi dhe objektivat e raportit**

Qëllimi i këtij raporti është përshkrimi i situatës së realizimit të drejtave të komunitetit romë/egjiptianë; analiza e situatës e të drejtave nisur kjo nga aksesit/ mundësia që kanë anëtarët e këtyre komuniteteve për të përfituar fillimisht nga shërbimet sociale.

Çështjet që ky raport ka marr në shqyrtim janë:

- Cilat janë nevojat e komunitetit romë/egjiptianë ?
- Cili është niveli i arsimimit të fëmijëve romë/egjiptianë?
- Cili është niveli i braktisjes së shkollës tek fëmijët romë/egjiptianë?
- Kush janë disa nga shkaqet që pengojnë arsimimin e këtyre fëmijëve?
- Cilat janë barrierat kulturore, institucionale dhe infrastrukturore që pengojnë arsimin cilësor të fëmijëve romë/egjiptianë?
- Sa është masa e përfitimit të anëtarëve të këtij komuniteti në të drejtën për përkujdes shëndetësor?
- A ndihen të diskriminuar anëtarët e komunitetit romë/egjiptianë ?
- Kush është shkalla e përfshirjes së anëtarëve të këtij komuniteti ?
- Në çfarë mase është përfshirja e këtij komuniteti në shërbime sociale ?
- Kush janë nevojat e shprehura nga vetë komuniteti por edhe nga aktorë të tjerë publik apo të shoqërisë civile për një integrim të këtij komuniteti ?
- Cilat janë efektet e politikave ekzistuese në lidhje me arsimimin e fëmijëve romë/egjiptianë por edhe të në lidhje me përfshirjen në kujdes shëndetësor; mbrojtje sociale e pjesëmarrje?

Ky raport studimi mund tu shërbejë njësive të qeverisjes vendore, Bashkive/ Komunave përkatëse ku ka vendndodhje të komunitetit romë dhe egjiptianë me qëllimin për të përmirësuar kushtet dhe standardet e jetesës së fëmijëve romë dhe egjiptianë. Gjithashtu, ky studim mund t'ju shërbejë institucioneve rajonale, organizatave të shoqërisë civile dhe personave të tjerë të interesuar për të përmirësuar situatën e të drejtave të fëmijëve romë dhe egjiptianë , - duke synuar integrimin e plotë të këtyre fëmijëve në jetën sociale.

---

<sup>4</sup> Realizimi i të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2008-2009, ACA/Observatori kombëtar, Kapitulli Qarku Shkodër

Raporti ofron një përshkrim të situatës apo gjendjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë në Qarkun Shkodër. Përmes analizimit të dhënave por edhe nga gjetjet cilësore të mbledhura nga puna me fokus grupet e realizuara, raporti thekson arritjet por edhe problematikat në fushën e të drejtave të fëmijëve të këtyre komuniteteve. Raporti përmban të dhëna, analiza, gjetje kryesore që i referohen vitit 2011 dhe disa edhe vitit 2012.

### *1. Metodologjia e studimit*

Për hartimin e raportit u morën shumë të dhëna nga institucionet rajonale si : DRSSH; DAR; DRF; QSH etj. Gjithashtu informacione u morën edhe nga institucionet e qeverisjes vendore si Këshilli i Qarkut, Bashkia Shkodër, Bashkia Vau i Dejës e Komuna Bërdicë. Shumë të vlefshme ishte edhe marrja e informacionit cilësor e sasior nga organizatat e shoqërisë civile si Sos Fshatrat e Fëmijëve, World Vision, Malteser të fokusuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve sociale apo në atë të fuqizimit të komunitetit romë/egjiptianë në Bashkinë Shkodër. Gjithashtu u organizuan fokus grupe me anëtarë të komunitetit në fjalë në territorin e Bashkisë Shkodër, Bashkisë Vau i Dejës dhe Komunën Bërdicë.

Raporti ka përdorur të dhëna sasiore të cilat janë të grumbulluara direkt nga fokus grupet por edhe nga burime të tjera të përmendura më lart; nga pyetësorët e drejtuara familjeve romë dhe egjiptiane, por edhe të dhëna cilësore të grumbulluara nga intervistimet me profesionistë të ndryshëm të përfshirë në fokus grupe. Analiza e të dhënave sasiore është bërë sipas elementëve të statistikës përshkruese ndërsa ato cilësore përmes teknikave të përpunimit të informacionit të natyrës cilësore.

#### *Desk review:*

Janë konsultuar fillimisht: Strategjia Rajonale në KQ dhe Plani i veprimit për Fëmijë 2011-2013; Strategjia kombëtare e fëmijëve; Udhëzim Nr. 06, datë 29.03.2006 “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje”, MASH; Raport “Për varfërinë dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit” Prill 2012; Raport i veçantë Nr.4 “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri “2009; Politikat e përfshirjes Sociale për Fëmijët dhe Financimi i tyre në Shqipëri, UNICEF; Raport mbi varfërinë e fëmijëve në Shqipëri bazuar në anketën e LSMS 2008,v.2010; Mapping Children Roma in Albania, CESS, November 2011.

Një seri prej 8 takimesh të organizuara në formën e fokus grupe, u realizuan me përfaqësues të komunitetit romë dhe egjiptianë; profesionistë të institucioneve shtetërore si dhe të shoqërisë civile në Qarkun Shkodër. Fokus grupet me komunitetin romë dhe egjiptianë u zhvilluan në 3 njësi të qeverisjes vendore me pjesëmarrjen e 30 anëtarëve në total, në: Bashkinë Shkodër, Bashkinë Vau i Dejës dhe fshatin Beltojë të Komunës Bërdicë. Këto janë dhe zonat të cilat kanë dhe përqendrim të numrit më të lartë të anëtarëve të komunitetit romë dhe egjiptianë në Qark. Gjithashtu pjesë e këtij studimi janë dhe shumë informacione të mbledhura nga vëzhgimet e drejta për drejta të realizuara në terren nga vetë zyra e Observatorit Shkodër.

U hartua dhe një pyetësor i cili ndihmoi për realizimin e intervistave dhe fokus grupeve me fëmijë, prindër, përfaqësues të komunitetit, mësues, edukatorë, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile. Ky pyetësor iu shpërnda 55 personave dhe kishte rreth 35 pyetje. (Në **Aneks 1** gjeni pyetësorin e realizuar sipas grupeve).

Disa nga çështjet kryesore të trajtuara ishin:

- Çfarë do të thotë të jesh anëtar i komunitetit romë dhe egjiptianë?
- Ç' do të thotë për ju diskriminim?
- Cilat janë nevojat kryesore të komunitetit tuaj?
- Sa rëndësi ka për ju arsimimi i fëmijëve?
- Çfarë iniciativash janë marre nga ju të rinjtë e komunitetit për promovimin e vlerave traditës, të drejtave që keni?
- Sa të përfshire keni qenë ju në vendimet e pushtetit lokal (për çështje që kanë të bëjnë me fëmijët)?
- A ka në institucionin tuaj një strategji të përcaktuar në lidhje me komunitetet e marginalizuara ?
- Çfarë nismash apo aktivitete janë ndërmarrë për të promovuar të drejtat e fëmijëve romë dhe egjiptianë ?
- Si e shikoni arsimimin e fëmijëve romë; përfshirjen në shërbime shëndetësore dhe sociale?

Ky raport ofron një panoramë të situatës së realizimit të drejtave të fëmijëve të komunitetit romë dhe egjiptianë në Qarkun Shkodër bazuar në 4 fushat kryesore: Kujdes Shëndetësor; Edukim; Mbrojtje Sociale dhe Pjesëmarrje. Të dhënat e marra nga institucionet shtetërore; institucionet rajonale; shoqëria civile apo nga fokus grupet me anëtarë të komuniteteve në fjalë dhe profesionistë të ndryshëm ofrojnë mundësinë e paraqitjes së situatës së gjendjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë, por nuk mund të ofrojë një tablo krejtësisht të plotë për shkak të kufizimeve të mëposhtme:

- Ka mungesë informacioni të ardhur nga institucionet shtetërore lidhur me të dhënat demografike mbi komunitetet romë e egjiptiane në Qarkun Shkodër.
- Nuk ka të dhëna të sakta, ose ato që ekzistojnë janë të pakta lidhur me ndarjen në grupmosha të fëmijëve në këto komunitete. Kjo pengon në vlerësimin e përlllogaritjen e saktë të masës së përfshirjes së fëmijëve në sistemin arsimor; kujdesin shëndetësor; mbrojtjen sociale apo mbi të drejtën për pjesëmarrje.
- Mungesa e të dhënave mbi ndarjen e buxheteve që shkojnë direkt për këtë kategori.

Por ky raport studimor pritet që të ngjallë kureshtjen e interesin e profesionistëve të qeverisjes vendore, profesionistëve në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale për të kuptuar më mirë e në thellësi gjendjen e fëmijëve të komunitetit romë dhe egjiptianë në Qarkun Shkodër.

Gjithashtu raporti në fjalë mund ti ndihmojë ato në ndërhyrjet në të ardhmen, në mënyrë që të plotësojnë më së miri nevojat e fëmijëve të komuniteteve romë e egjiptiane si dhe adreson në hartimin e politikave më favorizuese për këtë kategori të marginalizuar.

## **Kuadri Ligjor dhe Politikat e zhvillimit:**

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme të politikave të mbrojtjes sociale.

Në themel të tyre, pasqyrohen parimet themelore të KDF-së, e ratifikuar nga Shqipëria që nga viti 1992; detyrimet që dalin nga Objektivat e Mijëvjeçarit të Ri; instrumentet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara si dhe së fundmi Ligji për të Drejtat e Fëmijëve, të cilat theksojnë se fëmijët për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale kanë nevojë për mbrojtje më të veçantë nga familje dhe institucionet.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të Minoritetit Romë në Republikën e Shqipërisë përfshin një numër të konsiderueshëm dispozitash ligjore të parashikuara që në Kushtetutë; Kod Penal; Kod Civil; akte normative të Këshillit të Ministrave; Konventa; Strategji Kombëtare e Rajonale.

Dekada e Përfshirjes Rome 2005-2012 është iniciativa më e plotë për përmirësimin e jetës së romëve (Raport Studimor, Situata e Fëmijëve Romë në Shqipëri. Unicef /Save the Children, 2007).

Me anëtarësimin në Dekadën e Përfshirjes së Romëve Korrik 2008, MPÇSSHB ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e deklaratës "Dekada e Përfshirjes Rome". Në këtë kontekst doli si domosdoshmëri koordinimi i programeve, planeve dhe aktiviteteve ku shihet me përparësi ngritja e strukturës koordinuese gjithëpërfshirëse. Për këtë qëllim pranë Këshillit të Qarkut Shkodër është ngritur dhe funksionon Grupi Teknik për Çështjet Rome si pjesë e Komitetit të Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimeve që funksionon në këtë institucion. (Nga intervista me znj. Vilma Shiroka, Këshilli i Qarkut Shkodër). Gjithashtu në Planin e Veprimit për Fëmijë 2011-2013 pranë Qarkut Shkodër janë parashikuar masa konkrete për integrimin e komunitetit rom/egjiptian.

Sot mbrojtja e të drejtave të minoritetit romë përbën një nga kriteret e anëtarësimin të Shqipërisë në BE ( kriteri i Kopenhagës) (Raporti i Avokatit të Popullit për të drejtat e komunitetit romë në Shqipëri, v.2009).

### **Profili i komunitetit romë dhe egjiptianë**

Komuniteti (minoriteti) romë dhe komuniteti egjiptianë përfaqësojnë dy komunitete të cilët vazhdojnë të përballen me përjashtimin social. Ndërsa mund të themi se komuniteti egjiptianë është disi më i integruar në jetën shoqërore komuniteti romë është në pozita më pak të favorshme se egjiptianët.

Aktualisht komuniteti romë përfaqëson komunitetin më të varfër dhe të marginalizuar etnik në Shqipëri. <sup>5</sup>Papunësia masive e pas viteve 90' goditi Romët<sup>6</sup>, ata më shumë se çdo grup tjetër e gjetën veten të nxjerrë jashtë nga tregu i punës, duke e pasur të vështirë përfshirjen me kërkesat e tregut të ri të punës.

<sup>5</sup> CESS Mapping Roma Children in Albania,2012.

<sup>6</sup> Strategjia Rome,fq 12,2003



Familjet Rome karakterizohen me shumë anëtarë, të cilët nuk kanë të ardhura dhe kanë humbur punën, nuk janë në gjendje të sigurojnë të paktën një jetesë modeste dhe nuk mund të përballojnë strehimin në banesa me kushte të pranueshme dhe pagesën e faturave të shërbimeve publike. Kjo çon në lëvizjen e tyre drejt vend strehimeve ku ata janë të detyruar të jetojnë në kushte jo të shëndetshme dhe që nuk kanë status legal.

Kështu që ata bëhen akoma dhe më të distancuar nga shërbimet publike, shkollat dhe mundësitë e punësimit. Situata e Romëve nuk mund të thjeshtëzohet si një problem varfërie ose si çështje e një politike minoriteti. Në shqyrtimin e çështjes është e dukshme se në praktike konstatohen raste të përjashtimit dhe të vetë-përjashtimit si rezultat i rrethanave si ekonomike, sociologjike dhe psikologjike.

Karakteristikë tjetër për komunitetin Rom është jeta jo e qëndrueshme e tyre në vendbanime të caktuara. Pasojat që sjell kjo lëvizje e herë pas herëshme krijon probleme për këtë popullsi si dhe për vetë shtetin. Ndryshimi i ambientit ku jetojnë, lëvizja nga një shkollë tek tjetra, vështirësia për t'u ri-punësuar dhe integruar me jetën në një tjetër ambient, ka pasoja nga më të ndryshmet.

*Varfëria prek jo vetëm mirëqenien e fëmijëve në momentin kur mungojnë të mirat materiale dhe monetare, por ajo cenon edhe "mirë formimin e tyre".*

*Ajo cenon rëndë kapacitetin për të evoluar; vë në dyshim krijimin e potencialeve të nevojshme, si kapitalin e njohurive dhe dijeve, kapitalin kulturor, kapitalin social, kapitalin shëndetësor etj. Kjo pamjaftueshmëri e ndërtimit të "kapitalit human" rrezikon të çojë në atë që fëmija i varfër të bëhet një i rritur i varfër.<sup>7</sup>*

Mund të themi se *komuniteti egjiptianë* rezulton i regjistruar në Gjendjen Civile të Bashkisë Shkodër ndonëse nuk ofrohet një statistikë e veçantë ku të saktësohet mbi numrin e popullsisë së këtij komuniteti apo ndarjen në grupmosha të fëmijëve. Sipas Drejtorisë së Gjendjes Civile pranë Bashkisë Shkodër, komuniteti egjiptian figuron i regjistruar si çdo qytetar në këtë njësi administrative. Për këtë arsye nuk mund të ofrohen statistika të ndara nga pjesa tjetër e popullsisë, banorë të Bashkisë Shkodër.

*Komuniteti romë* në anën tjetër ka një shkallë pothuajse 100 % të mos regjistrimit në regjistrat e gjendjes Civile të Bashkisë Shkodër (e shprehur kjo edhe nga fokus grupet) apo njërive vendore të tjera ku ato aktualisht banojnë si në Bashkinë Vau i Dejës ashtu edhe në Komunën Bërdicë. Kjo bën që shumë nga familjet nuk përfitojnë nga skemat e NE-s për arsye se lëvizja e tyre nuk është shoqëruar me regjistrimin e tyre në zyrat e gjendjes civile të vendbanimeve të reja.

Komuniteti egjiptianë është i lokalizuar më shumë në banesa pranë Lagjes Liria dhe një pjesë përtej Urës së Bunës. Komuniteti romë është i vendosur në Bashkinë Shkodër, në Bashkinë Vau i Dejës dhe në fshatin Beltojtë të Komunës Bërdicë.

Në Bashkinë Shkodër vendbanimet e tyre janë: buzë lumit Buna; në një zonë në Tophanë; në zonën afër lagjes "Dubai" dhe përtej Urës së Bunës të përzier me popullsi egjiptiane. Komuniteti romë është targetuar si një komunitet lëvizës pra endacak dhe përgjithësisht jeton buzë lumenjve apo liqeneve.

---

<sup>7</sup> Profili i varfërisë së Fëmijëve në Shqipëri, 2011, fq 3

**Tabela 1** : Popullsia egjiptiane/ rome në Qarkun Shkodër.

**Burimi:** Popullsia egjiptiane, World Vision, DPA Project, Nëntor 2012. Popullsia rome Bashkia Shkodër -Save the Children projekti “Përfshirja rome në arsim”, Tetor 2012. Popullsia Rome në Bashkinë Vau i Dejës dhe Komuna Bërdicë nga fokus grupet e realizuara nga Observatori Shkodër, Dhjetor 2012-Janar 2013. Popullsia Rome vendndodhja Dubai, Malteser Shkodër,Janar 2013 (informacionet janë marrë nga fokus gupet me profesionistë të pushtetit vendor; shoqërisë civile dhe anëtarë të komuniteteve).

	<b>Egjiptianë, L' Liria"</b>	<b>Romë " buzë Bunës"</b>	<b>Romë Bashkia Vau i Dejës</b>	<b>Romë Komuna Bërdice</b>	<b>Romë Vendodhja Dubai,Bashkia Shkodër.</b>
Popullsia në total	910	247	11	36	200
Familje		50	4	8	40
Fëmije 0-18 vjec	264	113	8		60
Nga numri i Fëmijëve 0-18 vjec, Meshkuj	126	53	1		
Nga numri i Fëmijëve 0-18 vjec, Femra	138	60	7		

*Duhet theksuar se mbi popullsinë egjiptiane në Bashkinë Shkodër nuk ka të dhëna të ardhura nga rekordet administrative ose ato ekzistueset janë të varfra dhe nuk janë të sakta. E vetmja e dhënë e ofruar është nga shoqëria civile.*

Ndërsa sipas një vlerësimi të bërë nga UNICEF mbi vendndodhjen në total të popullsisë rome e përqendruar në bashkinë Shkodër<sup>8</sup> vlerësohet se në total janë 88 familje rome me 407 persona të ardhura nga Fushë Kruja, Elbasani, Tirana, Durrësi, Berati etj të vendosur në tre vendbanime të ndryshme ku jetojnë me çadra ose kasolle dhe në kushte shumë të vështira. Struktura e tyre fisnore është: 70% Karbuxhi, 10.3% Cergarë dhe 2.7% Meckar.

*Gjatë fazës së raportit dhe zhvillimit të fokus grupeve, çështja që na ra në sy është se akoma në nivelin e institucioneve shtetërore nuk ka një dallim mes komunitetit romë dhe egjiptianë. Shpeshherë të dhënat apo statistikat i referohen komunitetit romë ndërsa në të vërtetë flitet për komunitetin egjiptianë. Statistikat referuar këtyre komuniteteve janë akoma të varfra dhe nuk pasqyrojnë krejtësisht realitetin.*

*Gjithashtu duhet theksuar faktin se komuniteti romë karakterizohet nga të qënurit “lëvizës” ose “endacakë”; kjo bën që shpesh statistikat lidhur me gjendjen e komunitetit duhen rivlerësuar kohë pas kohe.*

<sup>8</sup> Shih [www.sidalbania.org](http://www.sidalbania.org)

### III - Analiza e studimit

#### Mbrojtja sociale

Fëmijët e komunitetit romë dhe egjiptianë përballen me një situatë të varfërisë por jo vetëm. Ato vuajnë përjashtimin social si shkak edhe i të ardhurave të ulëta të familjeve ku jetojnë. Niveli i ulët ekonomik i privon ato nga edukimi, kujdesi shëndetësor, përfshirja në jetën sociale etj. Kjo situatë i përball ato më punësimin në moshë të hershme, lypjen e kërkimin e lëmshës duke qenë më të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe fenomeneve negative që vijnë si pasojë e kësaj.

Lidhur me nivelin e varfërisë mund të themi se komuniteti egjiptianë si dhe ai romë jetojnë në kushte varfërie dhe nevojat bazë të familjes dhe fëmijëve nuk plotësohen. Situata paraqitet më e rënduar për komunitetin romë ku kushtet e jetesës janë jashtëzakonisht të vështira. Evidentuar dhe nga Observatori Shkodër, gjatë zhvillimit të fokus grupeve, vihet re se komunitetet rome e egjiptianë theksojnë nevojën e punësimit, të sigurimit të të ardhurave ekonomike për familjen dhe të një strehimi të përshtatshëm dhe të sigurt.

Nga të dhënat e mbledhura në terren, komuniteti romë i siguron të ardhurat kryesisht nga mbledhja e hekurishteve dhe përpunimi i tyre. Gjithashtu, kryesisht nënat rome, të shoqëruar shpesh nga fëmijët e tyre, sigurojnë të ardhurat përmes lypjes e lëmshave rrugëve të qytetit duke vendosur shpeshherë në rrezik fëmijët e tyre ose duke i privuar nga arsimimi.

Në lidhje me saktësi nivelin e punësimit apo të papunësisë së komuniteteve rome e egjiptiane, Observatori Shkodër kontaktoi “Drejtorinë e Punësimit”, të cilët u shprehën se nuk kanë statistika të popullsisë në total të komunitetit; gjithashtu ato mund të raportojnë dhe vlerësojnë vetëm individët e komunitetit romë dhe egjiptian që janë të regjistruar si punë kërkues.

Vlerësohet se zyrtarisht nga 119 kërkesa të ardhura si punëkërkues të komunitetit egjiptianë, gjatë vitit 2012, vetëm 2 prej tyre janë punësuar<sup>9</sup> me ndërmjetësimin e Drejtorisë Rajonale të Punësimit Shkodër (DRP), në ndryshim me vitin 2011 ku punësimi shënon 0 raste. Kjo tregon nivelin shumë të ulët të punësimit të këtij komuniteti. Ndërsa, nëse i referohemi komunitetit romë dhe nga kontaktet e zhvillimit të fokus grupeve në terren papunësia shkon në nivelin 100%. Gjithashtu lidhur me përfshirjen në skemën e Ndihmës Ekonomike, nga të dhënat zyrtare deklarohet se nga viti 2011 ka një zbritje nga 140 familje në 124 familje egjiptianë<sup>10</sup> që përfitojnë nga kjo skemë. Kjo tregon edhe nivelin shumë të ulët ekonomik të këtij komuniteti.

Problematika kryesore e komunitetit romë në Bashkinë Shkodër, Komunën Bërdicë dhe Bashkinë e Vau të Dejes është se ato nuk janë të regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile, Bashkia Shkodër; Ato rezultojnë të regjistruar kryesisht në zona të tjera si Elbasan, Fushë Krujë, Peqin etj, gjë që i përjashton ato jo vetëm nga aksesimi në pagesat e Ndihmës Ekonomike por edhe nga shërbime të tjera shumë të domosdoshme për këtë komunitet.

Niveli i mos regjistrimit të komunitetit romë në Bashkinë Shkodër, Bashkinë Vau të Dejes dhe në Komunën Bërdicë është në nivelin 100 %, pavarësisht politikave dhe vullnetin pozitiv të njësive vendore për ti ofruar regjistrim këtij komuniteti.

<sup>9</sup> Zyra Rajonale e Punësimit, Statistike e v.2012

<sup>10</sup> Statistikë nga Zyra e Shërbimit Social Rajonale, Janar 2013

## Kujdesi Shëndetësor

Nga zhvillimi i fokus grupeve është bërë evidente se një numër i konsiderueshëm i familjeve<sup>11</sup>, qoftë nga komuniteti egjiptianë apo romë, i neglizhojnë problemet shëndetësore e kryesisht të fëmijëve. Kjo situatë e vështirë shëndetësore lidhet me shumë faktorë, si: kushte të vështira banimi, varfëri, mungesë përfshirje në shërbimet shëndetësore, nivel i ulët ekonomik dhe i edukimit, mentaliteti i komunitetit etj. Shumë familje të komunitetit egjiptianë jetojnë në kushte të banesave të papërshtatshme për të rritur fëmijët e tyre, të cilat sipas Programit SOS Fshatrat e Fëmijëve Shkodër, - sipërfaqja e banesës nuk i kalon 50 m<sup>2</sup> ndërsa kushtet e banesës janë nën nivelin e një jetese të shëndetshme (lagështirë, mungesë higjiene, etj.), gjë që ndikon direkt në shëndetin e fëmijëve.

Ndërsa komuniteti romë përballë me kushte banimi ekstremisht të vështira, ajo çfarë u evidentua nga zhvillimi i fokus grupeve ishte se komuniteti romë jetonte në çadra, kasolle shpeshherë të mbuluara me plasmas, në një nivel higjiene aspak të favorshme, në një mjedis të papërshtatshëm për rritjen e fëmijëve dhe të rrezikuar nga fenomenet natyrore si përmblytjet, dëbora, të ftohtit të acartë etj.

Mungesa e regjistrimit zyrtar të komunitetit romë i privon ato nga mundësia e të pasurit libreza të shëndetit. Në këtë situatë të vështirë, anëtarët e komunitetit romë nuk mund të paguajnë për shërbimet shëndetësore dhe sigurim shëndetësor. Në mungesë të librezave shëndetësore shumë prindër romë marrin trajtimin shëndetësor për fëmijët e tyre vetëm në një stad të avancuar të sëmundjes.<sup>12</sup>

*Sipas të dhënave të ofruara nga Qendra Shëndetësore Nr.1, Ambulanca “28 Nëntori”, Bashkia Shkodër, e cila përfshin Lagjen Liria, janë rezident 402 fëmijë egjiptianë të moshës 0-14 vjeç, dhe vetëm 220 fëmijë egjiptian kanë librezat shëndetësore (referoju Grafikut 2). Ndërsa sipas informacionit të marrë nga fokus grupeve e organizuara, në ambientet e vendbanimit të komunitetit romë në Bashkinë Shkodër, Bashkinë Vau i Dejës dhe Komunën Bërdicë asnjë nga fëmijët e komunitetit romë nuk kanë librezat shëndetësore.*

Pavarësisht këtyre mangësive, në politikat shëndetësore parashikohet se edhe në mungesë të Librezave Shëndetësore çdo fëmijë i moshës 0-14 vjeç përfshihet në shërbime shëndetësore falas, duke theksuar se fëmijët janë të siguruar nga shteti.<sup>13</sup>

Mungesa e librezave shëndetësore në fakt i privon anëtarët e komunitetit romë, e kryesisht fëmijët, në marrjen e ilaçeve me rimbursim si dhe në përfshirjen e analizave laboratorike. Kjo bën që situata ekonomike të rëndohet edhe më tej në rastin e marrjes së medikamenteve në rast trajtimi të fëmijëve. Vaksinimi për fëmijët e komunitetit egjiptianë të lagjes Liria sipas statistikave rezulton në masën 98 %.


**Grafik 2 :** Paisja me librezat shëndetësi tek fëmijë egjiptianë

**Burimi:** Qendra Shëndetësore nr.1, Janar 2013

<sup>11</sup> Nga intervista me znj. Helga Smakaj, SOS Fshatrat e Fëmijëve, Programi i fuqizimit të familjes Shkoder.

<sup>12</sup> CESS Mapping Roma Children in Albania, 2012.

<sup>13</sup> Nga intervista me dr. Adriana Beljari, qendra Shëndetësore nr.1.



*Komuniteti romë*, i cili jeton në një situatë “barakash” apo “kasolle prej plastmasi” është edhe më i ekspozuar ndaj problemeve shëndetësore që mund të shkaktojnë këto kushte tejet të vështira jetese. Në tre komunitetet rome ku Observatori Shkodër zhvilloi fokus grupet (në Bashkinë Shkodër buzë lumit Buna; në Bashkinë Vau i Dejës dhe në fshatin Beltojë të Komunës Bërdicë) asnjë nga këto komunitete nuk kanë përfshirje në shërbime shëndetësore përjashtuar vetëm ato fëmijë të komunitetit romë<sup>14</sup> (buzë lumit Buna) në Shkodër të cilët janë të përfshirë në sistemin edukativ dhe janë të vaksinuar dhe kanë kryer kontrollet mjekësore mundësuar nga organizata ndërkombëtare Save the Children që operon në zonë dhe që po zbaton aktualisht një projekt në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Asnjë nga fëmijët e këtyre komuniteteve nuk janë të paisur me librezë shëndetësore.

### E drejta për Arsim

Ndjekja dhe regjistrimi i fëmijëve romë në kopshte dhe në arsimin e detyruar është një ndër objektivat strategjike të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, të “Programit Kombëtar për Braktisjen zero” dhe Planit të Veprimit për Dekadën Rome<sup>15</sup>. Sipas të dhënave që ofron DAR në Shkodër rezultojnë se shkalla e regjistrimit apo përfshirjes së komunitetit romë dhe egjiptianë në edukim është përkatësisht sipas tabelës së mëposhtme:


**Tabela 3 :** Shkalla e regjistrimit neto në arsim

**Burimi:** DAR Shkodër, Tetor 2012

Shtator 2011- qershor 2012	Arsim parashkollor	Arsim i detyrueshëm	Arsim i mesëm
Fëmijë të komunitetit romë	43	56	0
Fëmijë të komunitetit egjiptianë	35	266	9

**Grafik 4:** Shkalla e regjistrimit të fëmijëve rome ndaj atyre egjiptianë

**Burimi:** DAR Shkodër, Tetor 2012



Nga të dhënat kuptohet se komuniteti egjiptianë ka një shkallë regjistrimi më të lartë përkundrejt fëmijëve të komunitetit romë.

Fakti që nuk disponohen të dhëna të sakta mbi numrin e fëmijëve sipas grupmoshave të këtyre komuniteteve pengon përlogaritjen në përqindje të shkallës së regjistrimit në arsim.

<sup>14</sup> Bashkia Shkodër /Save the Children - Projekti” Përfshirja rome në edukim,Shkodër”.

<sup>15</sup> Nga raporti Vjetor i monitorimit dhe zbatimit të Ligjit “Për mbrojtjen e drejtave të Fëmijëve”ASHMDF.

Po sipas burimit të DAR Shkodër, numërohen rreth 9 shkolla të ciklit 9 vjeçar dhe 4 shkolla të mesme, në të cilat ka përfshirje të nxënësve romë e egjiptianë në edukim dhe gjithashtu.

Ndërsa sipas zhvillimit të fokus grupeve dhe bazuar në kontaktet direkt me anëtarë të komunitetit romë të vendosur në Bashkinë Shkodër (Buzë lumit Buna), në Bashkinë Vau i Dejës dhe në Komunën Bërdicë situata arsimore e fëmijëve rezulton si më poshtë:

**Tabela 5:** Përqindja e fëmijëve romë në edukim

Dhjetor 2012	Gjithsej fëmijë 0-18 vjeç	Numri i fëmijëve në edukim	Përqindje
Komuniteti Romë( Buzë Bunës)	113	42	37%
Komuniteti Romë( Bërdicë)	18	0	0%
Komuniteti Romë ( Vau i Dejës)	8	0	0%

**Burimi:** Informacioni mbi të dhënat të grupmoshës rome 0-18 vjeç në Bashkinë Shkodër buzë lumit Buna është marrë nga Sektori i Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Shkodër referuar projektit të SC-së “Përfshirja rome në edukim”. Ndërsa informacioni mbi të dhënat e po kësaj grupmoshe në Vaun e Dejës dhe Bërdicë janë marrë direkt nga fokus grupet e realizuara në këto njësi administrative. *Si i tillë, informacioni i fundit mund të merret me rezerva duke qenë se vijnë direkt nga thëniet e anëtarëve të fokus grupeve.*

Përllogaritja në përqindje lidhur me shkallën e përfshirjes në arsim është realizuar nga Observatori Shkodër.

Nga tabela shihet një përfshirje e ulët e fëmijëve të komunitetit romë të përmendur në shkallën e arsimit. Gjithashtu vlerësohet se edhe në vendndodhjen e komunitetit romë pranë lagjes Dubai në Bashkinë Shkodër, se rreth 60 fëmijë të këtij komuniteti nuk janë të përfshirë në sistemin arsimor<sup>16</sup>.

Organizata “Save the Children” në bashkëpunim me Bashkinë dhe DAR Shkodër po zbaton tashmë projektin e përfshirjes rome në edukim dhe punon direkt me komunitetin rome buzë lumit Buna. Si rezultat janë arritur që për herë të parë të përfshihen në sistemin arsimor fëmijë të këtij komuniteti dhe tashmë kjo është kthyer në një praktike dhe model pozitiv. Sipas të dhënave, aktualisht 23 fëmijë të këtij komuniteti janë të përfshirë në arsim parashkollor; 15 fëmijë janë në klasat e para, 5 fëmijë në klasën e dytë ( viti i dytë i përfshirjes) dhe 16 fëmijë ndjekin kurse kundër analfabetizmit.

Arsyet e përfshirjes së ulët të fëmijëve romë në sistemin arsimor lidhen me shumë shkaqe si: ekonomike, sociale apo nga mentaliteti i vetë komunitetit rreth arsimimit të fëmijëve.

Fëmijët romë shpeshherë për shkak të nivelit të ulët ekonomik të familjes detyrohen të kërkojnë lëmshë apo të lypin rrugëve; vajzat shpeshherë frenohen nga prindërit për frekuentimin e shkollës për shkak të mentalitetit; martesat në moshë të hershme ndodhin si për vajzat ashtu edhe djemtë. Gjithashtu, edhe vështirësitë gjuhësore apo fakti se disa nuk dinë gjuhën shqipe, problem ky kryesisht i komunitetit romë, ndikon negativisht dhe vështirëson përfshirjen në arsim ose bëhet

<sup>16</sup> Nga intervista me znj.Orjeta Cungu,Malteser Shkoder.

shkak për braktisjen e shkollës. Shpeshherë fëmijët nuk mbështeten nga familjet për shkak edhe të kapaciteteve të ulëta prindërore<sup>17</sup> si rezultat i nivelit të ulët arsimor; intelektual dhe ekonomik dhe kjo sjell si pasojë braktisjen e shkollës nga fëmijët.

**Tabela 6:** Braktisja e shkollës

**Burimi:** DAR Shkodër, 2012, Përqindja është përlogaritur nga Observatori Shkodër bazuar në të dhënat e DAR.

<b>Braktisja e shkollës nga fëmijët romë dhe egjiptianë- Shtator 2011</b>	<b>Numër</b>
Gjithsej romë klasa I-IX	56
Braktisës së shkollës romë	8
Braktisja në përqindje	14.3 %
Gjithsej egjiptianë klasa I-IX	266
Braktisës së shkollës egjiptianë	12
Braktisja në përqindje	4.5 %
Ndjekin Shansin II romë	0
Ndjekin Shansin II egjiptianë	3

Nga statistikat e ofruara nga DAR Shkodër lidhur me braktisjen vihet re tendenca e braktisjes së shkollës kryesisht pas përfundimit të ciklit fillor, në vazhdim të ciklit të lartë të arsimit të detyrueshëm dhe kjo lidhet me mentalitetin e komunitetit ndaj arsimit, martesat në moshë të hershme etj. Gjithashtu vlerësohet se:

*“Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që nuk frekuentojnë shkollën, në raport me numrin total të fëmijëve romë dhe egjiptianë që frekuentojnë shkollën, ka akoma një raport tepër të konsiderueshëm”.*

**Pjesëmarrja-fuqizimi i komunitetit.**

Fëmijët e komunitetit romë dhe gjithashtu egjiptianë vuajnë përjashtimin social si pasojë e të jetuarit brenda familjeve të varfra. Padyshim ka një lidhje të fortë ndërmjet varfërisë dhe përjashtimit social. Përjashtimi social shkaktohet nga varfëria familjare dhe shoqërore si rezultat i mos pasjes mundësi të prekjës së të mirave dhe shërbimeve të mjaftueshme që e bëjnë fëmijën të jetojë në periferi të shoqërisë. Kjo i distancon ato nga mundësitë për arsim, të ardhura për punë, dhe nga aktivitete të rrjetit të komunitetit. Ata nuk janë të përfshirë në vendimmarrje dhe si

<sup>17</sup> Nga intervista me znj. Helga Smakaj, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shkodër. Sos Shkodër po ofron aktualisht shërbime të ndryshme për të mundësuar të drejtën për edukim tek fëmijët e komunitetit egjiptianë; rritjes së kapaciteteve të mësuesve për të punuar me këtë komunitet; shërbime shëndetësore; reduktim të dhunës në familje si dhe për të garantuar të drejtën për një strehë të sigurtë.

rezultat i kësaj ato nuk janë në gjendje të ndikojnë mbi vendimet që prekin drejtpërdrejt interesat e tyre në jetën e përditshme.<sup>18</sup>

Nga zhvillimi i fokus grupeve nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në tre njësitë administrative rezulton se: anëtarët e komunitetit romë dhe egjiptian ndihen të diskriminuar për shkak se janë anëtarë të komunitetit romë dhe egjiptianë. Fakti se ato përjashtohen nga shërbime të caktuara publike, të pasurit e kapaciteteve të ulëta, vetë kategorizimi apo vetë izolimi i bën ato të pafuqishëm për të ushtruar të drejtën për pjesëmarrje apo të jenë pjesëmarrës në vendim marrje. Tek këto dy komunitete vihet re ose mungon fuqizimi për të kërkuar të drejtat e tyre tek institucionet vendore përgjegjëse .

### **Roli i OJF-ve**

Padyshim që shoqëria civile ka dhënë dhe vazhdon të japë një kontribut shumë të rëndësishëm në integrimin e fëmijëve të komunitetit romë dhe egjiptianë. Projektet e ndryshme që janë zbatuar dhe vazhdojnë të zbatohen nga OJF-të ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale ofrojnë modele e praktika pozitive në drejtim të ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre komuniteteve. OJF të ndryshme, si: SoS Fshatrat e Fëmijëve, World Vision, Save the Children, SHIS, Malteser etj, që operojnë në Qarkun Shkodër kanë ofruar ekspertizën e tyre në disa drejtime. Ato kanë mundësuar ofrimin e shërbime edukative, shëndetësore, nxitje e arsimimit tek fëmijët e këtyre komuniteteve, reduktim të dhunës në familje, ofrim shërbimesh për një strehë të sigurt, shërbim psikologjik, fuqizim komuniteti me qëllimin e integrimin të këtyre komuniteteve.

### **IV - Prezantimi i gjetjeve kryesore ( Sasiore dhe cilësore)**

- Anëtarët e komunitetit romë, kryesisht ato që jetojnë në çadra, tenda apo baraka pranë: lumit Buna - 247 anëtarë; Komuna Bërdicë - 36 anëtarë dhe në Bashkinë Vau i Dejës - 11 anëtarë, ***nuk rezultojnë të regjistruar*** në regjistrat e Gjendjes Civile të njërive administrative përkatëse ndonëse janë rezident në këto njësi. Pavarësisht vullnetit pozitiv të Bashkisë Shkodër për të mundësuar regjistrimin e tyre, një proces i tillë kushtëzohet nga mungesa e hapësirave ligjore.
- Si rrjedhojë e mos regjistrimit në Gjendje Civile dhe në zbatim të ligjit nr, 9355 “Për Ndhmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, këto familje ***nuk mund të trajtohen nga skemat e Ndhmës Ekonomike dhe të përfitojnë shërbime të tjera publike.***
- ***Kushtet mjedisore dhe të higjienës janë të papërshtatshme*** për një nivel jetesë të përshtatshme për fëmijët dhe janë të pafavorshme për të garantuar mirëqenien e tyre. Mungojnë ambientet miqësore për fëmijët si këndet e lojërave, - përgjithësisht në gjithë vendbanimet e komunitetit romë e egjiptianë sipas fokus grupeve të organizuar nga Observatori.
- ***Ka mungesa të ujit të pijshëm*** në vendbanimin e komunitet romë buzë Bunës, Komunës Beltojë ku këto komunitete janë instaluar. Gjithashtu edhe anëtarë të komunitetit egjiptianë në lagjen Liria Shkodër ***ankohen për higjienën e ujit të pijshëm.***
- Vetëm **2 anëtarë të komunitetit egjiptianë është bërë e mundur që të punësohen** me ndërmjetësimin e zyrës së Punës.
- **124 familje egjiptiane** në Bashkinë Shkodër përfitojnë nga skemat e Ndhmës Ekonomike.

<sup>18</sup> Profili i varfërisë së Fëmijëve në Shqipëri, Unicef, 2011.



- **Kushte shumë të vështira social ekonomike** - Shpeshherë fëmijët e komunitetit romë dhe egjiptianë janë të detyruar **të lypin** lëmosha rrugëve duke u përballuar me shumë fenomene negative shoqërore për shkak të nivelit të ulët të ardhurave në familje.
- Anëtarët e komunitetit rome dhe egjiptianë shprehen se **ndjehen të diskriminuar** për shkak se janë pjesëtarë të këtij komuniteti, **të veçuar dhe jo të përfshirë në jetën sociale të qytetit**.
- **Mentaliteti i komuniteteve** është jo favorizues në drejtim të arsimit kryesisht të vajzave duke sjellë një këndvështrim negativ **në aspektin e barazisë gjinore**. Shpeshherë celebrohen martesat në moshë të hershme dhe shpeshherë vajzat privohen nga arsimi i detyrueshëm jo vetëm për këtë shkak por edhe të qëndruarit në familje dhe rolit përkujdesës që duhet të këtë vajza ndaj aspekteve të shtëpisë.
- **Niveli i analfabetizmit** tek anëtarët e mëdhenj të komunitetit romë është shumë i lartë ndonëse ka praktika pozitive të përfshirjes së fëmijëve rome në sistemin arsimor. Vlerësohet se ka një përfshirje në sistemin arsimor në Bashkinë Shkodër, përkatësisht: 43 fëmijë rome e 35 fëmijë egjiptianë në parashkollor; 56 fëmijë romë e 266 fëmijë egjiptianë në arsimin e detyrueshëm; 0 fëmijë rome e 9 fëmijë egjiptianë në arsimin e mesëm; Në bashkinë Vau i Dejës dhe Komuna Bërdicë përfshirja në sistemin arsimor të fëmijëve romë raportohet 0.
- Vihet re tendenca e braktisjes së shkollës kryesisht pas përfundimit të ciklit fillor **në vazhdim të ciklit të lartë të arsimit të detyrueshëm** dhe kjo lidhet me mentalitetin e komunitetit ndaj arsimit; martesat në moshë të hershme etj.
- Nga të dhënat e ofruara nga DAR Shkodër vlerësohet se 56 fëmijë romë dhe 266 fëmijë egjiptianë ndjekin arsimin e detyrueshëm dhe gjithashtu 8 prej fëmijëve romë e 12 nga fëmijët egjiptianë konsiderohen braktisës së shkollës. Bazuar nga këto të dhëna, Observatori Shkodër ka përllogaritur shkallën e braktisjes së shkollës në përqindje. Kështu nga përllogaritja evidentohet se **Braktisja e shkollës** tek fëmijët romë vlerësohet 14.3 % ndërsa e fëmijëve egjiptianë 4.5 %.
- Paisja me Libreza të Shëndetit apo vizita mjekësore falas. Duke qenë se shumë anëtarë figurojnë të paregjistruar kjo sjell **pamundësinë për tu mbështetur edhe me shërbime shëndetësore** adekuate si qytetarë të Bashkisë Shkodër. Vetëm në Qendrën Shëndetësore nr.1 Ambulanca “28Nëntori” që përfshin lagjen Liria, nga 402 fëmijë të moshës 0-14 vjeç vetëm 220 janë të pajisur me Libreza Shëndetësore.
- **Strehimi, Arsimimi, Punësimi, Formimi profesional dhe përmirësimi i situatës social ekonomike** të komunitetit rome dhe egjiptianë do ndikonte pozitivisht në integrimin e tij/ saj në jetën shoqërore pasi ato ndjejnë dhe vuajnë përjashtimin social.

## V - Rekomandime

- Të evidentohet saktë gjendja e komunitetit romë dhe egjiptianë në Qarkun Shkodër dhe të ofrohen statistika mbi numrin e fëmijëve të këtyre komuniteteve; ndarja në grupmosha etj.
- Raportet ekzistuese apo hartëzimi i vendndodhjes së komunitetit romë të vlerësohet sipas një frekuence për shkak të karakterit endacak(lëvizës) të këtij komuniteti.
- Të mundësohet regjistrimi i anëtarëve të komunitetit romë dhe egjiptianë gjithashtu të cilët aktualisht banojnë në territorin e Qarkut Shkodër.
- Të rritet pjesëmarrja e fëmijëve romë e egjiptianë në sistemin arsimor parashkollor; të detyrueshëm dhe të mesëm;
- Tu ofrohet strehim i përshtatshëm komunitetit romë.

- Të përmirësohen kushtet mjedisore dhe të infrastrukturës të banimit të këtyre komuniteteve me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme jetese e zhvillim miqësor për fëmijët.
- Ngritja dhe vazhdueshmëria e projekteve për fuqizimin e familjeve të komunitetit romë dhe egjiptianë.
- Ofrimi i formimit profesional dhe ndërmjetësim për punësim për komunitetet romë e egjiptianë si një mënyrë për ti integruar ato në jetën shoqërore dhe rritur statusin ekonomik të familjeve;
- Shërbime edukative, orientuese, këshilluese për fëmijët romë egjiptianë e kryesisht ato që ndodhen jashtë arsimimit të cilët përballen me situatë rruge. Ngritja e shërbimeve adekuate në profilin e Qendrave Sociale apo Komunitare për këtë kategori.
- Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Rajonale për Fëmijët në Qarkun Shkodër 2011-2013 kryesisht objektivi: Krijimi i mundësive integruese për fëmijët romë dhe egjiptianë.

## BIBLIOGRAFI

1. Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijë 2011-2013, Këshilli i Qarkut Shkodër,2011.
2. Raport “ Realizimi i të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëroi 2008-2009” Aleanca Kombëtare për Fëmijët/Observatori Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, 2010.
3. Raport Studimor “ Situata e fëmijëve romë në Shqipëri” Unicef/Save the Children,2007
4. RAPORT I VEÇANTE Nr.4 “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri” Avokati i Popullit në Shqipëri, 2009.
5. Mapping Children Roma in Albania, CESS, November 2011
6. Studim “Profili i varfërisë së fëmijëve në Shqipëri në 2010”, UNICEF Shqipëri 2011.
7. Strategjia Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom”,OSCE, 2003
8. Adresa elektronike : [www.sidalbania.org](http://www.sidalbania.org) mbi hartëzimin digjital të komunitetit rom në Shqipëri, UNICEF/MPCSSHB
9. Raporti vjetor i Monitorimit të Zbatimit të Ligjit “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, 2011-2012 ASHMDF.

## **ANEKS 1**

### **Pyetësorët si instrumentë të studimit.**

**Periudha e realizimit:** Dhjetor 2012-Janar 2013

#### **Guidë interviste me prindër romë.**

1. Çfarë do të thotë të jesh pjesëtar i komunitetit rom/ egjiptian ?
2. Sa të përfshirë e ndjeni veten në jetën e përditshme lidhur me shërbimet publike në shëndetësi; mbrojtje shoqërore; edukim apo në të drejtën për pjesëmarrje ?
3. Si e kuptoni procesin e integritit dhe pjesëmarrjes?
4. Sa rëndësi ka për ju arsimimi i fëmijëve?
5. Çfarë vështirësish ke për ta dërguar fëmijën në shkollë ?
6. Çfarë mendon se do mund të bëhet ndryshe për të ndihmuar fëmijën tënd të arsimohet?
7. Kush janë pengesat që ndikojnë në mosplotësimin e të drejtave të komunitetit që ju përfaqësoni?
8. Kush janë disa nga nevojat kryesore të komunitetit që nëse do plotësoheshin do ndikonin pozitivisht në mirëqenien tuaj dhe të fëmijëve tuaj?

#### **Guidë interviste me të rinj të komunitetit (11-16 vjeç)**

1. Sa rëndësi ka për ju përfshirja në edukim?
2. A shkon në shkollë ? Nëse jo, përse ?
3. Nëse je i përfshirë në proceset edukuese çfarë vështirësish hasni?
4. Si e kuptoni mbështetjen e prindërve tuaj në edukimin tuaj?
5. A ndjeheni të diskriminuar?
6. Si e kuptoni procesin e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes?
7. Çfarë iniciativash janë marrë nga ju të rinjtë e komunitetit për promovimin e vlerave; traditës dhe të drejtave që ju keni ?
8. Sa të përfshirë keni qënë ju në vendimet e pushtetit lokal në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve?

#### **Guidë interviste me organizatat e shoqërisë civile**

1. Cilat janë iniciativat e organizatës suaj në integrimin e komunitetit romë/ egjiptianë ?
2. Kush janë disa nga vështirësitë e punës suaj në këtë proces integrimi ?
3. Çfarë e pengon komunitetin në fjalë që të fuqizohet dhe të kërkojë të drejtat e tyre?
4. Në cilët sektorë ose ku mendoni se ka mohim të drejtave të komunitetit rom /egjiptianë ?
5. Nëse ju punoni direkt për arsimimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve kush mendoni se nuk favorizon arsimimin e tyre ose favorizon braktisjen e shkollës ?
6. Çfarë hapash mund të ndërmerren për përmasimin e situatës së përfshirjes së komuniteteve në shërbime publike adekuate ?

#### **Guidë interviste me aktorë publik**

1. Cilat janë disa nga politikat favorizuese që po ndërmerr institucioni juaj në lidhje me fëmijët

rom/egjiptian?

2. Çfarë iniciativash janë ndërmarrë direkt për garantimin e të drejtave të fëmijëve rom/egjiptian?
3. Si e vlerësoni pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje?
4. Cilët janë disa nga bashkëpunimet e institucionit tuaj me organizata të shoqërisë civile lidhur me promovimin dhe garantimin e të drejtave të këtyre fëmijëve?
5. Cili është niveli i frekuentimit / braktisjes / problematikat dhe politikat që ndërmerrni lidhur me Arsimimin e fëmijëve rom/egjiptian?
6. Sa përfshirje kanë këto fëmijë në shërbime shëndetësore dhe mbrojtje shoqërore?
7. Çfarë masat mund të ndërmerren në të ardhmen për integrim të plotë të komunitetit në shoqëri?

### **Guidë intervistash me edukatorë e mësues**

1. Cili është frekuentimi i fëmijëve rom/egjiptian në institucionin tuaj arsimor?
2. Cilat janë arsyet e mos frekuentimit ose braktisjes nëse ka ?
3. Si është procesi edukativ tek këto fëmijë. Me çfarë vështirësish përballen ?
4. Kush janë disa nga problematikat që vijnë direkt nga komuniteti që ndikojnë në procesin edukativ të fëmijëve ?
5. Sa mendoni se këto fëmijë mbështeten nga vetë prindërit ?
6. kush janë disa nga sfidat që mund të adresohen për ta përmisuar situatën ?